



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më, 11.03.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datës 30 janar dhe të datave 4, 5, 6, 11 dhe 12 shkurt 2019.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III”” (*Komision për dhënie mendimi*).

3. Korrespondenca drejtuar komisionit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Linidita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Të ftuar

Illir Bejtja – Zëvendësministër i në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës,

Agim Bregasi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës,

Ardian Islami – përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e ditës së sotme të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Në rendin e ditës kemi dy çështje: miratimin e procesverbaleve të datës 30 janar dhe të datave 4, 5, 6, 11 dhe 12 shkurt 2019, si dhe diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III””.

Për këtë projektligj jemi komision për dhënie mendimi, por, pavarësisht kësaj, ne duhet të bëjmë një raportim dhe ta depozitojmë te komisioni përgjegjës. Në lidhje me këtë projektligj, për të na dhënë sqarimet e nevojshme, të pranishëm në komision janë zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër i Energjetikës dhe Infrastrukturës, si dhe personat që e shoqërojnë atë zoti Agim Bregasi dhe zoti Ardian Islami. Relator i këtij projektligji është zoti Ismet Beqiraj.

Përpara se të kalojnë në diskutimin e këtij projektligji, do t’i pyesja kolegët e komisionit nëse kanë ndonjë vërejtje, korrigjime apo sugjerime për procesverbalet e datave që sapo ju përmenda. Gjithsesi, në qoftë se keni ndonjë sugjerim të vogël, kalojani sekretarisë. Më pas, ato do të publikohen në faqen e *web*-it të Kuvendit.

Sa i takon projektpropozimit për fazën III të programit për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, ne në komision kemi diskutuar edhe dy fazat e mëparshme, ku përfaqësues keni qenë po ju. Por, përveç kësaj, kemi kuptuar edhe rëndësinë e këtij programi edhe nga angazhimi që ka pasur komisioni ynë në “Paktin për universitetin”.

Përpara se t’ia kaloj fjalën zotërinjve që kanë ardhur nga ministria, zoti Beqiraj, a keni ndonjë gjë për të thënë si relator i projektligjit?

Ismet Beqiraj – Pika që do të diskutojmë sot ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy qeverive, qeverisë gjermane dhe qeverisë shqiptare, për t’u financuar nga KfW-ja në lidhje me programin për rinovimin e konvikteve të kampusit universitar të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, që është në vazhdim të realizimit. Kjo ka qenë e miratuar edhe më parë, por përshpejtimi i këtij procesi dhe përthithja e investimeve

për të ndryshuar gjendjen e konvikteve, është edhe në kuadër të programit afatmesëm dhe të shpejtë që ka qeveria shqiptare dhe që lidhet drejtpërdrejtë me paktin për universitetin. Kjo, në një farë mënyre, është një zgjidhje konkrete e shqetësimeve të shprehura, të evidentuara dhe tashmë të dala edhe nga studentët dhe banorët e këtij qyteti.

Ky program, që është faza 3-të, është edhe në kuadër të kredisë dhe të granteve që qeveria shqiptare ka marrë nga qeveria gjermane. Unë nuk kam se çfarë t'ju them më shumë, pasi risitë e këtij projekti janë konkrete, por uroj të ketë edhe projekte të tjera, në mënyrë që problemet që ka jo vetëm kampusi universitar, sidomos pjesa e konvikteve të Qytetit Studenti të Universitetit të Tiranës, të shtrihen në të gjitha konviktet e universiteteve publike shqiptare.

Ne jemi në rrugë të mbarë dhe uroj që shumë shpejt edhe në muajt pasardhës të ratifikojmë marrëveshje të tjera.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Siç e tha edhe zoti Beqiraj ky është një projekt në vazhdim, i cili ka filluar me konviktet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, ku ne kemi rehabilituar 4 godina dhe janë akomoduar 580 studentë. Ky nuk është thjesht një projekt për përmirësimin e performancës energjetike, por nënkupton rehabilitimin e të gjithë ndërtesës për ta bërë atë me të gjitha kushtet moderne për jetesën komunitare të studentëve, qoftë sa u takon kushteve të akomodimit, si uji i ngrohtë, banjat e reja dhe e gjithë infrastruktura sanitare e rinovuar, por, gjithashtu sjell edhe një performancë të re energjetike, e cila në godinat në fjalë deri tani ka rezultuar me 20% kursim të energjisë. Ky kursim pritet të jetë në të njëjtat nivele edhe në projektin në vazhdim, pra për 9 godinat e Qytetit Studenti Nr. 1, ku 5 prej tyre janë përcaktuar dhe do të përcaktohen edhe 4 të tjera, të cilat do të restaurohen, si dhe parashikohet që investimi të rikthehet mbrapsht për qeverinë shqiptare, para që mund të investohen nëpër sektorë të tjerë për 6 vjet, vetëm nga kursimi i energjisë.

Gjithashtu, duke qenë se sot përdoren nafta ose karburantet e tjera për ngrohjen e ujit në Qytetin Studenti, këto nuk do të përdoren më, gjë që do të thotë se do të kemi një ulje edhe të dioksidit të karbonit në zonë, pra një përmirësim edhe të kushteve mjedisore.

Sa u takon 9 godinave që ju përmenda, atje do të akomodohen 1800 studentë dhe më pas projekti do të vazhdojë edhe me rehabilitimin e 24 godinave të tjera të Qytetit Studenti Nr. 1,

auditimi i të cilave do të bëhet me këtë grant dhe me rreth 155 mijë euro të vendosura për këtë qëllim nga KfW-ja, banka gjermane.

Projekti do të zgjasë rreth 30 muaj dhe arsyet e zgjatjes së këtij projekti lidhen me jetesën në konvikte të studentëve. Pra, nuk është e mundur që Qyteti Studenti të zbrazet dhe ne të mund të punojmë në front të gjerë, dhe paralelisht me këtë do të fillojë edhe financimi i pjesës së mbetur. Ashtu siç ju mund të keni dëgjuar edhe për raste të tjera, me 18 milionë euro financim të butë, përsëri në kuadrin e marrëveshjes që ne kemi me qeverinë gjermane për programin e eficiencës së energjisë dhe po brenda kësaj marrëveshjeje, janë edhe 7 milionë euro të tjera grant, çka do të thotë se janë para të mjaftueshme për ta mbyllur gjithë rregullimin e Qytetit Studenti me kushte perfekte jetese. Pra, do të ketë një ndryshim vërtet cilësor dhe do të zgjidhen më shumë sesa vetë kërkesat e studentëve gjatë protestës së tyre, me gjithë këtë investim dhe rehabilitim.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Sa konvikte bëhen gjithsej?

Ilir Bejtja – Bashkë me 9 konviktet, në total bëhen 13. Pra, 4 prej tyre janë mbyllur me një shumë prej 5,2 milionë euro, vlefata e kontraktimit për konviktet e Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërsa këto të tjerat i takojnë qytetit Studenti Nr. 1, janë 9 godina gjithsej së bashku me auditimin e 24 godinave të tjera që mbeten. Në total i gjithë investimi shkon në rreth 35-36 milionë euro, por kjo varet nga vlefata e kontraktimit, sepse janë me tender.

Milva Ekonomi – Po, zoti Çela.

Bujar Çela – Në radhë të parë, do të doja të përgëzoja ministrinë, e cila është interesuar për këtë marrëveshje. Ne, si komision, kemi qenë gjithmonë pro kësaj marrëveshjeje që u shërben studentëve, të cilët kanë qenë dhe mbeten prioriteti i kësaj qeverie.

Unë doja të dija se si janë godinat që janë përcaktuar për t'u futur në radhën e rikonstruksionit, sepse nuk janë vetëm ato godina, por ka edhe shumë të tjera. Pra, do të doja të dija se çfarë kriteri është ndjekur për radhën e përcaktimit dhe si do të jetë ecuria e tyre? A do të përmirësohen të mirat apo ato më të këqijat për t'i bërë shumë më të mira?

Faleminderit!

Ardian Islami – Më lejoni t'ju informoj që radha është për 5 godinat, të cilat i përkasin marrëveshjes së fazës I dhe fazës II, që tashmë janë përcaktuar. Këto janë përcaktuar në bazë të një auditimi energjetik e zhvilluar nga vetë KfW-ja, e cila ka vlerësuar edhe kushtet aktuale të

godinave, por kuptohet, kriteri kryesor ka qenë amortizimi i tyre. Ndërkohë, për 4 godinat e tjera që jemi duke folur, pasi në total do të jenë 9 godina, është përcaktuar një raport dhe do të kryhet një vlerësim auditimi energjetik, i cili përsëri do të vlerësojë kriteret, ku kriteri bazë do të jetë amortizimi i ndërtesës dhe, më pas, është diskutimi ndërmjet palëve, ku edhe vetë administrata e Qytetit Studenti ka prioritetet e saj në bazë të përcaktimit të rikonstruksioneve të godinave.

Ilir Bejtja – Doja t’ju sqaroja edhe diçka. Kohë më parë ne kemi miratuar këtu në komisionin tuaj ligjin për eficiencën e energjisë në ndërtim. Ne kemi një target, i cili parashikon rehabilitimin e rreth 2% të të gjithë fondit publik të ndërtesave çdo vit. Pra, projekti nuk mjaftohet vetëm me ndërtesat e Qytetit Studenti, por do të vazhdojë më tej me financime përsëri të qeverisë shqiptare, nëse do të jenë kredi të buta apo grant, është një projekt që do të vazhdojë deri në vitin 2030, vit në të cilin ne do të kemi mbyllur komplet fondin e ndërtesave publike dhe efienca ka si objektiv kursimin e rreth 15% të energjisë në total të asaj që harxhohet sot.

Parashikohen ndërhyrje në volume, në sistemet mbrojtëse, në ngrohjen e tyre, në kushtet sanitare të çdo godine, të cilat konsiderohen edhe ura energjetike. Sot që jemi duke folur, ne kemi një inefficiencë totale prej rreth 13-14% energji më shumë sesa do të donte në të vërtetë një objekt. Sa i përket të gjitha ndërtimeve të tjera për çdo ndërtesë të re që lëshohet sot nga Këshilli Kombëtar i Territorit apo nga organet kompetente, asnjë projekt nuk miratohet në qoftë se nuk respekton standardet dhe kriteret e eficiencës energjetike në ndërtim. Ndërkohë, po në ligj është përcaktuar qartazi, gjë që ka filluar të zbatohet për të gjitha organet që licencojnë restaurimin e godinave të vjetra, nëse restaurohet më shumë se 25% e volumit të godinës, e gjithë godina duhet të restaurohet dhe të sillet në kushtet e eficiencës energjetike, pavarësisht nëse është publike ose jo.

Fadil Nasufi – Marrëveshja që kemi përpara është e plotë dhe e qartë nga pikëpamja e procedurës parlamentare, si dhe shpjegimet shteruese të përfaqësuesve të ministrisë, por për arsye të një komunikimi më praktik, më publik, do të doja që zotërinjtë e ministrisë të na sillnin disa të dhëna. Pra, si janë implementuar fazat e para të marrëveshjes që kemi miratuar? Sa studentë përfitues janë? Modelet e ndërhyrjeve, tipat e dhomave dhe standardi bashkëkohor që është future, jo thjesht për treguesit e eficiencës së energjisë dhe të praktikave që parashikon marrëveshja, me qëllim që, duke u mbështetur edhe në “Paktin për universitetin”, të jemi sa më konkretë që, më pas, fazat e tjera të mbështetjes financiare, qoftë me grante apo qoftë nga marrëveshjet e tjera, të jenë në kuadrin e gjithë programit që ka shpallur qeveria, për të ndryshuar situatën jo vetëm për

akomodimin bashkëkohor dhe cilësor të studentëve, por për të gjitha pikat e tjera të “Paktit me universitetin”.

Pra, ne kërkojmë vetëm disa të dhëna nga ana juaj, në mënyrë që të flasim me shifra dhe më konkretisht.

Ilir Bejtja – Materialin që kërkuat, do t’jua dërgoj që sot, pasi ne e kemi bërë gati, sepse na e kanë kërkuar edhe komisionet e tjera. Ne do t’ia dërgojmë sekretares dhe ju do të keni mundësinë ta shpërndani.

Vilma Bello – Ju përsëndes dhe ju falënderoj për informacionin!

Unë i bashkohem asaj që tha kolegu Nasufi, pasi pyetja ime e parë kishte të bënte pak a shumë me atë që ju pyeti ai.

Pyetja tjetër që unë kam është: sa do të shtrihen këto investime në qendrat studentore jashtë Tiranës, pra nëpër rrethe? Çfarë projekti konkret ka për shtrirjen e mëtejshme të këtyre investimeve? Konkretisht pyetja ime lidhet për qendrën studentore “Ismail Qemali” të qarkut të Vlorës.

Ilir Bejtja – Në total i gjithë programi përfshin rreth 55 milionë euro, pra 35 milionë euro shkojnë për Tiranën, pasi aty ndodhet edhe kampusi më i madh i konvikteve, ndërsa pjesa tjetër do të vazhdojë për të gjitha universitetet e rretheve, gjithmonë flas për universitetet publike, ndërkohë që të tjerët janë të detyruar të ndjekin të njëjtin standard.

Milva Ekonomi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III””.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Hedhim projektligjin në votim në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Falënderoj zotërinjtë që ishin të pranishëm dhe u uroj suksese!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më, 11.03.2019, ora 13:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3. Korrespondenca drejtuar komisionit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Linidita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Dua t'ju bëj me dije edhe një çështje tjetër. Meqë ne jemi komision përgjegjës edhe për institucionet që varen nga parlamenti, sidomos institucionet e pavarura, natyrisht që ndjekim nga afër punën e tyre, sidomos atë të Radiotelevizionit Shqiptar. Ka një korrespondencë ndërmjet Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit, SUADA, dhe Radiotelevizionit Shqiptar lidhur me pagesat për disa përdorime që i janë bërë të drejtës së autorit, pa u dhënë shpërblim. Ndërkohë, ka ardhur korrespondenca e plotë midis këtyre dy enteve, ku Radiotelevizioni Shqiptar jep në mënyrë shteruese të gjitha arsyet pse nuk ka bërë një pagesë dhe se si e ka ndjekur nga pikëpamja ligjore këtë kërkesë të bërë nga SUADA, duke e çuar çështjen deri në apel.

Doja t'ju bëja me dije që ky informacion ka pak ditë që ka ardhur, në fillim të muajit mars, në komisionin tonë dhe një fotokopje të korrespondencës e kemi këtu në komision. Në qoftë se keni nevojë për ta parë, ju bëj me dije se SUADA kërkon një pagesë, ndërkohë është bërë një korrespondencë dhe është kthyer një përgjigje, por ajo nuk ka qenë e bindur nga përgjigjja dhe ka bërë një ankimim në gjykatë. Procesi ka vazhduar dhe tani është në apel.

Kjo ishte vetëm për t'ju vënë në dijeni.

Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi, por shumë shpejt do të bëjmë një mbledhje për kalendarin. Ju vetë besoj se e keni dëgjuar sot që ne, si komision, kemi edhe një instrument tjetër, i cili është kontrolli parlamentar, prandaj duhet të mendojmë për interpelancat, për pyetjet që do t'u drejtojmë ministrave dhe duhet ta vazhdojmë kontrollin tonë parlamentar në territor.

Nga sesioni i kaluar ne, si komision, kemi bërë kontrolle në shtet e trashëgimisë kulturore, por kemi edhe disa të tjera, si: Bylisi, Apolonia, Shkodra dhe Korça...

Fidel Ylli – Para kësaj, ne u kemi dhënë fjalën dhe kemi marrë një ftesë nga Universiteti i Sporteve për të shkuar atje, dhe kjo është më kryesorja. Ndërkohë, po diskutohet edhe paketa e sportit dhe ne, si komision, sot ishim në Kryeministri. Ata na kanë sjellë një shkresë dhe ne do t'i vizitojmë, pasi nga ai universitet dalin të gjithë filizat e sportit dhe bëhet edukimi i të gjithë kuadrove. Prandaj duhet të shkojmë një herë si komision...

Milva Ekonomi – Dakord.

Meqë vizitat në universitete i shtymë për arsytet që dihen, në fillim duhet të merremi me çështjen e sportit, pasi është edhe momenti. Javën që vjen duhet të bëjmë kalendarin dhe të marrim përsipër që ditën e martë dhe të mërkurë të punojmë në komision dhe të mendojmë për një vizitë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rregull, por pa praninë tuaj nuk do të shkojmë në Universitetin e Sporteve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të mërkurën pasdite do të shkojmë në Elbasan.

Unë me Fidelin dhe me sekretarinë po bëjmë gati një draft-kalendar, më pas, ju e shihni dhe ne do ta miratojmë në komision.

I gjithë komisioni ka marrë një njoftim për një dëgjuesë me grupin e të drejtave të njeriut për dhunën, për situatën ekonomike, situatën sanitare shëndetësore që ka pjesa e grave të komunitetit rom. Kjo dëgjuesë ishte lënë për në datën 13, ora 13:00, por ky aktivitet është shtyrë për një afat tjetër dhe për këtë arsye po ju bëj njoftimin dhe besoj se të gjithë jeni dakord.

Ju uroj punë të mbarë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA